



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1582/6 prot.

Datë 04.09.2023

V E N D I M
Nr. 875/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.09.2023 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

“Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “NRG” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66559-04-19-2023, me objekt: Loti 4 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”, me fond limit 15.479.671 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.”

“Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66559-04-19-2023, me objekt: Loti 4 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”, me fond limit 15.479.671 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.”

“Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “RSM Company” SHPK.

Ankimues:

Operatori ekonomik “NRG” SHPK me NIPT (L13426006B), me adresë Rruga “Eduart Mano”, Pallatet Nr.10, Kopshti Zologjik, Selitë, Tiranë.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK me NIPT (L71715003C), me adresë, Rruga “Kavajës”, Godina “Condor Centre”, Kati 4, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara Bulevardi ”Dëshmorët e Kombit”, Nd.1, 1001, Tiranë

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “Florfarma” SHPK me NIPT (K21405001N), me adresë lagjia “Prush”, Ndërtese 3 katëshe, kati 1-rë, kati 2-të me sipërfaqe 80 m2 dhe kati i 3-të - Prodhim i barnave, Zona Kadastrale 3064, Pasuria Nr.39/11, Florfarma 1, Vaqarr, Tiranë.

Operatori ekonomik “RSM Company” SHPK me NIPT (70658046), me adresë Çagllavicë, P.N, Prishtinë, Kosovë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.04.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66559-04-19-2023, me objekt: Loti 4 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”, me fond limit 15.479.671 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 13.06.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 23.06.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Florfarma” SHPK	10.055.023.272	kualifikuar
2. “RSM Company” SHPK	10.800.000	skualifikuar
3. BOE “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK	12.389.232	skualifikuar
4. BOE “AFA Group” SHPK & “Du&Ko” SHPK	13.899.964	skualifikuar
5. “NRG” SHPK	14.640.768	kualifikuar

II.4. Në datën 30.06.2023, në Sistemin e Prokurimit Elektronik është publikuar Njoftimi i Fituesit Paraprak të procedurës së prokurimit.

II.6. Në datën 06.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur ankesa me nr. 1582 prot., datë 06.07.2023 SHPK e operatorit ekonomik “NRG” i cili kundërshton kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “Florfarma” SHPK.

“Bazuar sa më sipër, po paraqesim këtë formular ankese duke kërkuar skualifikimin e ofertës së OE “Florfarma” SHPK. Produkti Aquatain që ka ofertuar ky OE për kryerjen e shërbimit nuk plotëson kërkesat ligjore dhe ato teknike të dokumentave të tenderit.

Ana ligjore.

Në shtojcën e DT nr.1 datë 01.06.2023 janë shtuar si kritere kualifikimi:

[...]

[...]

Produkti Aquatain nuk është product biocid me lëndë vepruese Bacillus thuringensis israeliensis (B.t.i), ose Bacillus thuringensis israeliensis (B.t.i.) I kombinuar me Bacillus sphaericus dhe si i tillë nuk plotëson specifikimet teknike të dokumentave të tenderit.

[...]

Produkti Aquatain nuk figuron në listën e lëndëve vepruese që përmban produkti biocid referuar të dhënave të ECHA-s dhe në këto kushte ky OE nuk plotëson kriterin e shtuar të kualifikimit duke mos paraqitur në ofertën e tij:

- *certifikatën e rregjistrimit në një prej vendeve të përcaktuara në Ligjin nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”.*
- *autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi për lëndët biocide.*
- *etiketat/katalogët/skedat teknike të produktit biocid*

[...]

Për ta përmbledhur kemi të bëjmë me kualifikimin e një OE me:

- *Një produkt që nuk përmbush specifikimet teknike të tenderit gje e cila jo e skualifikon automatikisht.*
- *Nuk ka të dhëna shkencore të çertifikuara nga ente europiane.*
- *Nuk ekziston kuadër ligjor shqiptarë që rregullon përdorimin dhe administrimin gjë e cila merr rëndësi të veçantë kur flasim për një program kombëtar të kontrollit të mushkonjave.”*

Në dokumentat e tenderit është kërkuar: [...]

Nga klasifikimi i ofertave rezulton se OE “Florfarma” shpk ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit:

Loti 1 – [...]

Loti 2 – [...]

Loti 4 – [...]

Duke qenë se ky OE ka ofertuar në më shumë se një Lot duhet të paraqiste në ofertë një deklaratë ku të listoheshin dokumentet e paraqitura në përmbushje të kritereve kumulative për Lotin konkret, deklaratë e cila nuk është paraqitur nga ky OE në secilin lot ku ka ofertuar.

Në dokumentat e tenderit është kërkuar:

[...]

Vlera e fondit limit të 3 loteve ku ka ofertuar ky OE është 34 100 071 lekë pa TVSH. Bazuar në kriterin e mësipërm të kualifikimit ky OE duhet të paraqiste dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në vlerën jo më pak se 13 299 027 lekë pa TVSH. Ky OE ka dështuar në plotësimin e këtij kriteri kualifikimi pasi nuk ka paraqitur dëshmi për shërbime të ngjashme në vletën minimale prej 13299 027 lekë pa TVSH. Sa më sipër oferta e këtij OE duhet të skualifikohet për mospërbushjen e këtij kriteri kualifikimi.

Në dokumentat e tenderit është kërkuar:

[...]

Numri I punonjësve për lotin objektin e ankimimi është 2 (dy).

Por ky OE ashtu sikurse theksuam edhe më sipër ka marrë pjesë në:

Lotin 1 – [...]

Lotin 2 – [...]

Pra kriteri kumulativ është që ky OE duhet të ketë minimum 4 (katër) punonjës shërbimi. Duke qenë se kriter kualifikimi është kërkuar staf për kryerjen e shërbimit, operatorët ekonomikë kishin detyrimin të paraqesnin kontratat e punës në mënyrë kumulative për aq punonjës sa kërkoheshin për lotet ku kishin ofertuar por edhe document provues (listëpagesat e muajit të fundit me kodin përkatës për punonjës shërbimi DDD ose dëshmi përkatëse për teknik DDD).

Nuk mund të quhet e vlefshme vetëm kontrata e punës me një punonjës kur nuk provohet se ai është punonjës shërbimi DDD.

Në objektin e veprimtarisë së tij OE “Florfarma” shpk ka disa aktivitete të tjera përveç shërbimit DDD por kjo nuk do të thotë që të kualifikohet duke paraqitur kontrata fictive punonjësish që nuk kanë të bëjnë me shërbimin – objekt prokurimi.

Ajo që provon se këta punonjës janë vërtet punonjës shërbimi DDD e vërteton ose dëshmia/certifikata e specializimit si teknik DDD ose listëpagesa e muajit të fundit me kodin korrespondues të punonjësit të shërbimit teknik DDD. [...]

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1582/2 prot., datë 07.07.2023, duke publikuar kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “NRG” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.6.2. Me anë të shkresës nr.948/3 prot., datë 13.07.2023, protokolluar me tonën me nr.1582/3 prot., datë 19.07.2023, me objekt “Vënie në dijeni mbi zgjatjen e afatit për shqyrtimin e ankesës”, duke informuar se “[...] Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara ju vë në dijeni se nisur nga nevoja për një verifikime lidhur me pretendimet e ngritura në ankesën e protokolluar me tonën me nr. Prot. 948, datë 06.07.2023, e regjistruar

në KPP me nr. Protokollu 1580/2023, datë 06.07.2023, nga operatori ekonomik "NRG" SHPK; ankesës protokolluar me tonën me nr. Prot. 949, datë 06.07.2023, e regjistruar në KPP me nr. 1581/2023, datë 06.07.2023, ankesës protokolluar me tonën me nr. Prot. 950, datë 06.07.2023, e regjistruar në KPP me nr. 1582/2023, datë 06.07.2023, si dhe ankesës protokolluar me tonën me nr. 954 prot., datë 06.07.2023, e regjistruar në KPP me nr. 1583/2023, datë 06.07.2023, për vlerësimin e procedurës së prokurimit, "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar-Shërbime", me objekt "Shërbim dezinfektimi" me nr. REF-66549-04-19-2023, ka ndërprerë afatin për shqyrtimin e ankesave [...]"

II.6.3. Në datën 22.08.2023, protokolluar pranë KPP-së me nr.1582/4, operatori ekonomik "Florfarma" SHPK ka paraqitur shkresën me objekt "Informacion", ku ngre pretendimi mbi Vendimin e shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik NRG shpk, nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6.4. Me anë të shkresës Nr.950/2 prot., datë 16.08.2023, protokolluar me tonë me nr. 1582/5 prot., datë 29.08.2023, me objekt "Dërgohet vendim mbi ankesën", autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik "Vendim mbi shqyrtimin e ankesës së ankimesit "NRG" SHPK", me nr.950/1 prot., datë 15.08.2023, ku konstatohet, se ankesa e këtij të fundit është pranuar si më poshtë vijon:

"Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi dokumentat e tenderit, si dhe pretendimet e parashtruara në ankesë nga operatori ekonomik ankimes "NRG" SHPK, dhe konstatoi:

Nisur nga pretendimet e parashtruara në ankesë nga ankimesi lidhur me plotësimin e specifikimeve teknike të produktit të paraqitur nga ofertuesi "FLORFARMA" SHPK, organi qendror blerës, gjendur në kushtet kur në pretendimet e parashtruara si dhe specifikimet teknike në DST ka informacion dhe të dhëna teknike të cilat kërkojnë trajtim dhe shqyrtim nga specialist të fushës, si dhe duke pasur në vëmendje se hartues i specifikimeve teknike është Autoriteti kontraktor, Instituti i Shëndetit Publik i cili ka hartuar kërkesën për prokurim dhe specifikimet teknike dhe gjithashtu ka kapacitetet profesionale për verifikimin e specifikimeve teknike i është drejtuar më shkresë nr.948/2 Prot., datë.13.07.2023 këtij të fundit duke kërkuar nëse produkti i paraqitur nga ky ofertues është ose jo në përmbushje të specifikimeve teknike.

Si rezultat i nevojës së lindur për verifikim KSHA ka ndërprerë afatet për shqyrtimin e ankesës bazuar në nenin 114, pika 2 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikës 3, neni 100, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik dhe operatorin ekonomik ankimes me shkresën nr. 927/2 prot., datë 11.07.2023.

ISHP me shkresën nr. 948/5 Prot., datë.27.07.2023, ka kthyer përgjigje si vijon:

Produkti AQUATAIN me lende aktive Polidimetil siloksan (silikon), përmbush specifikimet teknike për kryerjen e nderhyrjeve të rekomanduara për kontrollin e larvave të mushkonjave sipas habitateve për kategoritë B dhe C si më poshtë:

B. Trajtime periodike me larvicide në puseta dhe bodrume me ujë.

C. Kryerja e shërbimit për eliminimin e vatrave të shumimit të larvave të mushkonjave në zona urbane (hapësira publike dhe private), dhe trajtime me larvicide të vatrave që nuk mund

te eliminohen. Vatrata, qe eshte e pamundur te eliminohen (p.sh. rezervuare te medhenj me uje, shatervane, etj), duhet te trajtohen me produkte larvicide.....”

Produktet larvicide qe duhet te perdoren per kategorite “B dhe C” Bazuar ne sa me siper per trajtimin e pusetave dhe bodrumeve rekomandohet te perdoren produkte larvicide me lende vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i.) i kombinuar me *Bacillus sphaericus* ose barriera fizike njeshtresore ose ekuivalent me efikasitet te provuar dhe kohezgjatje te aktivitetit prej te pakten kater javesh ne habitatet specifike.....].

Produkti AQUATAIN me lende aktive Polidimetil siloksan (silikon), nuk permbush specifikimet teknike per kryerjen e nderhyrjeve te rekomanduara per kontrollin e larvave te mushkonjave sipas habitateve te kategorise “A” si me poshte:

A. Trajtime periodike me larvicide ne Zona te Mbrojtura Natyrore (ZMN) vatra te perkohshme dhe te perhershme ne laguna, parqe, kanale, pellgje etj, sipas zonave te percaktuara nga autoriteti kontraktor.

Produktet larvicide qe duhet te perdoren per kategorine "A" Sherbimi i dezinfektimit ne habitatet e mesiperme përfshin zonat bregdetare dhe urbane. Lagunat bregdetare te vendit tone jane zona te mbrojtura natyrore nga konventa kombetare dhe nderkombetare dhe te gjitha kanalet qe trajtohen ne zonen bregdetare derdhen drejtperdrejte ose indirekt ne det. Produktet larvicide qe duhet te perdoren per trajtimin e habitateve te mesiperme nuk duhet te jene toksike/ te rrezikshme per organizmat ujore dhe tokësorë jo target dhe nuk duhet te jene të dëmshëm për njerëzit, kafshët dhe mjedisin dhe me efikasitet jo më pak se sa dy javë. Në zonat e mbrojtura natyrore, për të ruajtur mjedisin e ndjeshëm pranohet vetëm përdorimi i produkteve larvicide me lende vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i) ose *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.T.I) i kombinuar me *Bacillus sphaericus* ose ekuivalent, me kusht që ekuivalenti të mos demtojë dhe të mos jetë toksik për gjallesat e tjera dhe të jetë me efikasitet të provuar dhe kohëzgjatje të aktivitetit prej të paktën 2 javësh në habitatet specifike.....]

Produkti Aquatain nuk është produkt biocid, por është larvicid që vepron si barrierë fizike, duke penguar larvat dhe pupat e mushkonjave të thithin oksigjenin nga sipërfaqja pasi bllokon sifonin e aparatit të frymëmarrjes së tyre me anë të shtresës që krijon në sipërfaqe. Ky mekanizëm veprimi është i ndryshëm nga ai i produkteve me lëndë vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i) ose *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.T.I) i kombinuar me *Bacillus sphaericus*, të cilët clirojnë toksina në traktin tretës të larvave të mushkonjave dhe këto toksina kanë specificitet të lartë të lidhen me receptorët e qelizave epiteliale të mureve të brendshme të aparatit tretës vetëm të larvave të mushkonjave. Bazuar në studime kërkimore shkencore mbi efektin e Aquatain ndaj organizmave jo-target, është konstatuar se produkti ka ndikim jo vetëm mbi larvat dhe pupat e mushkonjave, por edhe mbi gjallesa të tjera si invertebrorët e grupit të Notonoktidëve (<https://ëëë.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3126853/> <https://ëëë.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3126853/pdf/pone.0021713.pdf>).

Gjithashtu, raportet bashkëlidhur tregojnë mbi efektet negative të Aquatain tek zogjtë lidhur me ndikimin e tij mbi aftësinë e tyre fluturuese, pluskimin në sipërfaqe të ujit dhe kontrollin e temperaturës së trupit (<https://ëëë.rivm.nl/documenten/factsheet-silicon-polymer-use-for-pest-control>), (<https://apvma.gov.au/sites/default/files/publication/13906-prs-polydimethylsiloxane.pdf>) dhe në raportin e ekspertëve të misionit TAIEX i kryer në vendin

tonë në nëntor 2022 për kontrollin e larvave të mushkonjave në zonat e mbrojtura natyrore rekomandohet përdorimi i larvicideve me lëndë vepruese Bti i kombinuar ose jo, me Bs.”

Në datë 31.07.2023, ASHPP i është drejtuar me shkresë nr. 1085 Prot., ISHP-së me anë të së cilës ka kërkuar vënien në dispozicion të një specialist fushe, me qëllim trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave, në përputhje me përcaktimet ligjore nisur nga natyra dhe specifika e objektit të prokurimit.

Në përgjigje të kërkesës së një sipërme ISHP me shkresën me nr. 1085/1 Prot., datë 07.08.2023 ka vendosur në dispozicion ekspertin e fushës.

Eksperti i fushës i cili shqyrton këtë ankesë pranë ASHPP-së, gjithashtu edhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të ngritur pranë ISHP-së lidhur me shqyrtimin e specifikimeve teknike të produktit AQUATAIN në përmbushje të specifikimeve teknike të vendosura në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin lidhur me këtë ankesë gjykon si vijon:

Në vijimësi të qëndrimit të mbajtur nga Komisioni i ngritur pranë ISHP-së shton se

- Produkti AQUATAIN më lëndë aktive Polidimetil siloksan (silikon), përmbush specifikimet teknike për kryerjen e ndërhyrjeve të rekomanduara për kontrollin e larvave të mushkonjave sipas habitateve për kategoritë B dhe C.

- **Produkti AQUATAIN më lëndë aktive Polidimetil siloksan (silikon), nuk përmbush specifikimet teknike për kryerjen e ndërhyrjeve të rekomanduara për kontrollin e larvave të mushkonjave sipas habitateve të kategorisë "A".**

Produkti Aquatain nuk është produkt biocid, por është larvicid që vepron si barriere fizike, duke penguar larvat dhe pupat e mushkonjave të thithin oksigjenin nga sipërfaqja pasi bllokun sifonin e aparatit të frymëmarrjes së tyre me anë të shtresës që krijon në sipërfaqe. Ky mekanizëm veprimi është i ndryshëm nga ai i produkteve me lëndë vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i.), ose *Bacillus tliuringensis israeliensis* (B.t.i.) i kombinuar me *Bacillus sphaericus*, të cilët çlirojnë toksina në traktin tretës të larvave të mushkonjave dhe këto toksina kanë specifikitet të lartë të lidhen me receptorët e qelizave epiteliale të mureve të brendshme të aparatit tretës vetëm të larvave të mushkonjave. Bazuar në studime kërkimore shkencore mbi efektin e Aquatain ndaj organizmave jo- target, është konstatuar se produkti ka ndikim jo vetëm mbi larvat dhe pupat e mushkonjave, por edhe mbi gjallesa të tjera si invertebrorët e grupit të Notonoktidëve (<https://ëëë.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3126853/> <https://ëëë.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3126853/pdf/pone.0021713.pdf>).

Gjithashtu, raportet bashkëlidhur tregojnë mbi efektet negative të Aquatain tek zogjtë lidhur me ndikimin e tij mbi aftësinë e tyre fluturuese, pluskimin në sipërfaqe të ujit dhe kontrollin e temperaturës së trupit (<https://ëëë.rivm.nl/documenten/factsheet-silicon-polymer-use-for-pest-control>), (<https://apvma.gov.au/sites/default/files/publication/13906-prs-polydimethylsiloxane.pdf>).

Në raportin e ekspertëve të misionit TAIEX i kryer në vendin tonë në nëntor 2022 për kontrollin e larvave të mushkonjave në zonat e mbrojtura natyrore rekomandohet përdorimi i larvicideve me lëndë vepruese Bti i kombinuar ose jo, me Bs.

Për gjithë sa me sipër pretendimi i ankimesit “NRG” SHPK qëndron.”

II.7. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK është skualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

- *Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat sipas Pikës 1 Seksioni 2.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” të Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit sipas shtojcës 1 dt.01.06.2023, pasi operatori “VLERA” sh.p.k pajisut me NIPT nga organet tatimore në Kosovë me nr. 81OI98772 nuk ka paraqitur Liçencën për kategorinë II.8.B. Në zbatim të nenit 88, të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, kushti për licensën është i detyrueshëm për seicilin nga antarët e bashkimit të operatorëve pasi kapacitetet teknike duhet të vërtetohen nga sicili antar në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim. Gjithashtu operatori i huaj në këtë rast VLERA sh.p.k nuk mund të kryejë shërbime të dezinsketimit në territorin e Republikës së Shqipërisë me licensën e lëshuar në Kosovë por detyrimisht duhet të ishte paisur me Liçencën për kategorinë II.8.B, sipas shtojcës 1 të DST dhe Legjislacionit në fuqi, përpara paraqitjes të ofertës në formën e bashkimit të OE.*

- *Nga bashkimi i operatorëve “EGIAN MED” sh.p.k dhe “VLERA” sh.p.k në Kontratën e Bashkëpunimit midis operatorëve është deklaruar ndarja e punëve përkatësisht: “VLERA” sh.p.k merr përsipër 39% të punëve dhe “EGIAN MED” sh.p.k 63% të punëve. Ndërkohë në zërat e vlerave të deklaruar në tabelën e ndarjes së punëve, shifrat e deklaruar nga përfitimi i ndarjes së punëve sipas zërave janë të ndryshme nga ajo e deklaruar nga kontrata e bashkëpunimit, pasi rezulton se “VLERA” sh.p.k do të kryjë 27% të ofertës dhe “EGIAN MED” sh.p.k të 73% ofertë.*

II.7.1. Në datën 10.07.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3254, si dhe nr. protokoli 1610/2023 datë 10.07.2023 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK, si dhe lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “RSM Company” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7.2. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1610/2 prot., datë 11.07.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK, si dhe duke publikuar kriteret për të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimi. Gjithashtu, në ankesën e tij bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, pretendon se oferta e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK është anomalisht e ulët.

Në lidhje me operatorin ekonomik “RSM Company” SHPK, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues pretendon si më poshtë (citojmë):

“ - Lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “RSM Company” SHPK.”

II.7.3. Me anë të shkresës Nr.965/5 prot., datë 24.07.2023, protokolluar me tonë me nr. 1610/4 prot., datë 27.07.2023, me objekt “*Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: Loti 4 “Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”*”, si dhe shkresës Nr.965/4 prot., datë 21.07.2023, protokolluar me tonë me nr. 1610/5 prot., datë 27.07.2023, me objekt “*Dërgohet vendimi mbi ankesën*”, ndër të tjera autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “*Vendim mbi shqyrtimin e ankesës së ankimuesit “Egian Med” SHPK*”, me nr.965/3 prot., datë 21.07.2023, ku konstatohet, se ankesa e këtij të fundit është refuzuar.

II.8. Me anë të shkresës nr. 714/1 prot., datë 25.07.2023, protokolluar pranë KPP-së me nr.1610/7 prot., datë 28.07.2023, Instituti i Shëndetit Publik na vendos në dijeni se: “[...] *Sqarojmë se z.R nuk është pjesë përbërëse e Komisionit për Autorizimin e Produkteve Biocide. Bazuar ne VKM nr.933, datë 25.11.2020, Instituti I Shëndetit Publik nuk ka të drejtë vendimmarrje për dhënie e Autorizimeve të Produkteve Biocide, por I jep mendim MSHMS në bazë të një vlerësimi që kryhet nga specialistet përkatës për çdo produkt biocid. Ky mendim më pas shqyrtohet nga Komisioni për Autorizimin e Produkteve Biocide në MSHMS. Z. E.R nuk kryen vlerësimin e PB insecticide (PT 18) në kuadër të procedurës së autorizimit të produkteve biocide. Në lidhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, nuk ka patur kërkesa për sqarime apo ankimime lidhur me këto specifikime pas publikimit të procedurës. Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, të kryer nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, Z. Rnuk është pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për këtë procedurë.*”

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK, për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK, me arsyetimin se “[...] *Produkti Aquatain nuk është product biocid me lëndë vepruese Bacillus thuringensis israeliensis (B.t.i), ose Bacillus thuringensis israeliensis (B.t.i.) I kombinuar me Bacillus sphaericus dhe si i tillë nuk plotëson specifikimet teknike të dokumentave të tenderit.*

[...]

Produkti Aquatain nuk figuron në listën e lëndëve vepruese që përmban produkti biocid referuar të dhënave të ECHA-s dhe në këto kushte ky OE nuk plotëson kriterin e shtuar të kualifikimit duke mos paraqitur në ofertën e tij:

- certifikatën e rregjistrimit në një prej vendeve të përcaktuara në Ligjin nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”.
- autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi për lëndët biocide.
- etiketat/katalogët/skedat teknike të produktit biocid

[...]

Për ta përmbledhur kemi të bëjmë me kualifikimin e një OE me:

- Një produkt që nuk përmbush specifikimet teknike të tenderit gje e cila jo e skualifikon automatikisht.
- Nuk ka të dhëna shkencore të çertifikuara nga ente europiane.
- Nuk ekziston kuadër ligjor shqiptarë që rregullon përdorimin dhe administrimin gjë e cila merr rëndësi të veçantë kur flasim për një program kombëtar të kontrollit të mushkonjave.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Me anë të shkresës Nr.950/2 prot., datë 16.08.2023, protokolluar me tonë me nr. 1582/5 prot., datë 29.08.2023, me objekt “Dërgohet vendim mbi ankesën”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës së ankimesit “NRG” SHPK”, me nr.950/1 prot., datë 15.08.2023, ku konstatohet, se ankesa e këtij të fundit është pranuar si më poshtë vijon:

“Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi dokumentat e tenderit, si dhe pretendimet e parashtruara në ankesë nga operatori ekonomik ankimesit “NRG” SHPK, dhe konstatoi:

Nisur nga pretendimet e parashtruara në ankesë nga ankimesi lidhur me plotësimin e specifikimeve teknike të produktit të paraqitur nga ofertuesi “FLORFARMA” SHPK, organi qendror blerës, gjendur në kushtet kur në pretendimet e parashtruara si dhe specifikimet teknike në DST ka informacion dhe të dhëna teknike të cilat kërkojnë trajtim dhe shqyrtim nga specialist të fushës, si dhe duke pasur në vëmendje se hartues i specifikimeve teknike është Autoriteti kontraktor, Instituti i Shëndetit Publik i cili ka hartuar kërkesën për prokurim dhe specifikimet teknike dhe gjithashtu ka kapacitetet profesionale për verifikimin e specifikimeve teknike i është drejtuar më shkresë nr.948/2 Prot., datë.13.07.2023 këtij të fundit duke kërkuar nëse produkti i paraqitur nga ky ofertues është ose jo në përmbushje të specifikimeve teknike.

Si rezultat i nevojës së lindur për verifikim KSHA ka ndërprerë afatet për shqyrtimin e ankesës bazuar në nenin 114, pika 2 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 3, neni 100, të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik dhe operatorin ekonomik ankimesit me shkresën nr. 927/2 prot., datë 11.07.2023.

ISHP me shkresën nr. 948/5 Prot., datë.27.07.2023, ka kthyer përgjigje si vijon:

Produkti AQUATAIN me lende aktive Polidimetil siloksan (silikon), përmbush specifikimet teknike për kryerjen e nderhyrjeve të rekomanduara për kontrollin e larvave të mushkonjave sipas habitateve për kategoritë B dhe C si më poshtë:

B. Trajtime periodike me larvicide në puseta dhe bodrume me ujë.

C. Kryerja e sherbimit per eliminimin e vatrave te shumimit te larvave te mushkonjave ne zona urbane (hapesira publike dhe private), dhe trajtime me larvicide te vatrave qe nuk mund te eliminohen. Vatrata, qe eshte e pamundur te eliminohen (p.sh. rezervuare te medhenj me uje, shatervane, etj), duhet te trajtohen me produkte larvicide.....”

Produktet larvicide qe duhet te perdoren per kategorite “B dhe C” Bazuar ne sa me siper per trajtimin e pusetave dhe bodrumeve rekomandohet te perdoren produkte larvicide me lende vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i.) i kombinuar me *Bacillus sphaericus* ose barriera fizike njeshtresore ose ekuivalent me efikasitet te provuar dhe kohezgjatje te aktivitetit prej te pakten kater javesh ne habitatet specifike.....].

Produkti AQUATAIN me lende aktive Polidimetil siloksan (silikon), nuk permbush specifikimet teknike per kryerjen e nderhyrjeve te rekomanduara per kontrollin e larvave te mushkonjave sipas habitateve te kategorise “A” si me poshte:

A. Trajtime periodike me larvicide në Zona të Mbrojtura Natyrore (ZMN) vatra të përkohshme dhe të përhershme në laguna, parqë, kanale, pellgje etj, sipas zonave të percaktuara nga autoriteti kontraktor.

Produktet larvicide qe duhet te perdoren per kategorine "A" Sherbimi i dezinfektimit ne habitatet e mesiperme përfshin zonat bregdetare dhe urbane. Lagunat bregdetare te vendit tone jane zona te mbrojtura natyrore nga konventa kombetare dhe nderkombetare dhe te gjitha kanalet qe trajtohen ne zonen bregdetare derdhen drejtperdrejte ose indirekt ne det. Produktet larvicide qe duhet te perdoren per trajtimin e habitateve te mesiperme nuk duhet te jene toksike/ të rrezikshme per organizmat ujore dhe tokësore jo target dhe nuk duhet te jene të dëmshëm për njerëzit, kafshët dhe mjedisin dhe me efikasitet jo më pak se sa dy javë. Në zonat e mbrojtura natyrore, për të ruajtur mjedisin e ndjeshëm pranohet vetëm përdorimi i produkteve larvicide me lende vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i) ose *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.T.I) i kombinuar me *Bacillus sphaericus* ose ekuivalent, me kusht që ekuivalenti të mos demtojë dhe të mos jetë toksik për gjallesat e tjera dhe të jetë me efikasitet të provuar dhe kohëzgjatje të aktivitetit prej të paktën 2 javësh në habitatet specifike....]

Produkti Aquatain nuk është produkt biocid, por është larvicid që vepron si barrierë fizike, duke penguar larvat dhe pupat e mushkonjave të thithin oksigjenin nga sipërfaqja pasi bllokon sifonin e aparatit të frymëmarrjes së tyre me anë të shtresës që krijon në sipërfaqe. Ky mekanizëm veprimi është i ndryshëm nga ai i produkteve me lëndë vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i) ose *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.T.I) i kombinuar me *Bacillus sphaericus*, të cilët clikojnë toksina në traktin tretës të larvave të mushkonjave dhe këto toksina kanë specificitet të lartë të lidhen me receptorët e qelizave epiteliale të mureve të brendshme të aparatit tretës vetëm të larvave të mushkonjave. Bazuar në studime kërkimore shkencore mbi efektin e Aquatain ndaj organizmave jo-target, është konstatuar se produkti ka ndikim jo vetëm mbi larvat dhe pupat e mushkonjave, por edhe mbi gjallesa të tjera si invertebrorët e grupit të Notonoktidëve (<https://ëëë.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3126853/> <https://ëëë.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3126853/pdf/pone.0021713.pdf>).

Gjithashtu, raportet bashkëlidhur tregojnë mbi efektet negative të Aquatain tek zogjtë lidhur me ndikimin e tij mbi aftësinë e tyre fluturuese, pluskimin në sipërfaqe të ujit dhe kontrollin e

temperaturës së trupit (<https://ëëë.rivm.nl/documenten/factsheet-silicon-polymer-use-for-pest-control>),

(<https://apvma.gov.au/sites/default/files/publication/13906-prs-polydimethylsiloxane.pdf>) dhe në raportin e ekspertëve të misionit TAIEX i kryer në vendin tonë në nëntor 2022 për kontrollin e larvave të mushkonjave në zonat e mbrojtura natyrore rekomandohet përdorimi i larvicideve me lëndë vepruese Bti i kombinuar ose jo, me Bs.”

Në datë 31.07.2023, ASHPP i është drejtuar me shkresë nr. 1085 Prot., ISHP-së me anë të së cilës ka kërkuar vënien në dispozicion të një specialist fushe, me qëllim trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave, në përputhje me përcaktimet ligjore nisur nga natyra dhe specifika e objektit të prokurimit.

Në përgjigje të kërkesës së një sipërme ISHP me shkresën me nr. 1085/1 Prot., datë 07.08.2023 ka vendosur në dispozicion ekspertin e fushës.

Eksperti i fushës i cili shqyrton këtë ankesë pranë ASHPP-së, gjithashtu edhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të ngritur pranë ISHP-së lidhur me shqyrtimin e specifikimeve teknike të produktit AQUATAIN në përmbushje të specifikimeve teknike të vendosura në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin lidhur me këtë ankesë gjykon si vijon:

Në vijimësi të qëndrimit të mbajtur nga Komisioni i ngritur pranë ISHP-së shton se

- Produkti AQUATAIN më lëndë aktive Polidimetil siloksan (silikon), përmbush specifikimet teknike për kryerjen e ndërhyrjeve të rekomanduara për kontrollin e larvave të mushkonjave sipas habitateve për kategoritë B dhe C.

- Produkti AQUATAIN më lëndë aktive Polidimetil siloksan (silikon), nuk përmbush specifikimet teknike për kryerjen e ndërhyrjeve të rekomanduara për kontrollin e larvave të mushkonjave sipas habitateve të kategorisë "A".

Produkti Aquatain nuk është produkt biocid, por është larvicid që vepron si barriere fizike, duke penguar larvat dhe pupat e mushkonjave të thithin oksigjenin nga sipërfaqja pasi bllokon sifonin e aparatit të frymëmarrjes së tyre me anë të shtresës që krijon në sipërfaqe. Ky mekanizëm veprimi është i ndryshëm nga ai i produkteve me lëndë vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i.), ose *Bacillus tliuringensis israeliensis* (B.t.i.) i kombinuar me *Bacillus sphaericus*, të cilët çlirojnë toksina në traktin tretës të larvave të mushkonjave dhe këto toksina kanë specifikitet të lartë të lidhen me receptorët e qelizave epiteliale të mureve të brendshme të aparatit tretës vetëm të larvave të mushkonjave. Bazuar në studime kërkimore shkencore mbi efektin e Aquatain ndaj organizmave jo- target, është konstatuar se produkti ka ndikim jo vetëm mbi larvat dhe pupat e mushkonjave, por edhe mbi gjallesa të tjera si invertebrorët e grupit të Notonoktidëve

(<https://ëëë.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3126853/>

<https://ëëë.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3126853/pdf/pone.0021713.pdf>).

Gjithashtu, raportet bashkëlidhur tregojnë mbi efektet negative të Aquatain tek zogjtë lidhur me ndikimin e tij mbi aftësinë e tyre fluturuese, pluskimin në sipërfaqe të ujit dhe kontrollin e temperaturës së trupit(<https://ëëë.rivm.nl/documenten/factsheet-silicon-polymer-use-for-pest-control>),

(<https://apvma.gov.au/sites/default/files/publication/13906-prs-polydimethylsiloxane.pdf>).

Në raportin e ekspertëve të misionit TAIEX i kryer në vendin tonë në nëntor 2022 për kontrollin e larvave të mushkonjave në zonat e mbrojtura natyrore rekomandohet përdorimi i larvicideve me lëndë vepruese Bti i kombinuar ose jo, me Bs.

Për gjithë sa me sipër pretendimi i ankimesit “NRG” SHPK qëndron.”

III.1.2. Neni 30 Ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se:

1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

4. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor nuk ka marrë vendim sipas përcaktimeve të nenit 114 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik menjëherë, por, në çdo rast, jo më vonë se 3 ditë nga mbarimi i afatit të mësipërm, i kërkon dërgimin e informacionit apo

dokumentacionit përkatës. Në këtë rast, autoriteti ose enti kontraktor, brenda 3 ditëve nga marrja dijëni, ka detyrimin të paraqesë në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është jo më vonë se 20 ditë.

5. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës Komisioni i Prokurimit Publik ka nevojë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta ose të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Afati për marrjen e vendimit nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të vërë në dijëni palët.

Sa më sipër, KPP gjykon, se duke qenë se autoritetit kontraktor, ka pranuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK si më sipër, në mbështetje të nenit 115 pika 2 e LPP, Komisioni Prokurimit Publik vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK, për sa kohë që operatori ekonomik i interesuar “Florfarma” SHPK nuk ka paraqitur argumente sipas nenit 113 të LPP.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK me argumentin, se “Në dokumentat e tenderit është kërkuar: [...]

Nga klasifikimi i ofertave rezulton se OE “Florfarma” shpk ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit:

Loti 1 – [...]

Loti 2 – [...]

Loti 4 – [...]

Duke qenë se ky OE ka ofertuar në më shumë se një Lot duhet të paraqiste në ofertë një deklaratë ku të listoheshin dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret, deklaratë e cila nuk është paraqitur nga ky OE në secilin lot ku ka ofertuar., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca “8, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, për Lotin 4, “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar: [...]

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike -

financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Autodeklaratë datë 13.06.2023, në lidhje me Punonjësit që disponon për kryerjen e shërbimit.

III.2.3. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriteve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.4. Sa më sipër, referuar kriterit të mësipërm të kualifikimit, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që *“Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriteve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriteve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriteve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriteve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme”*. Pra, sa më sipër, autoriteti kontraktor kërkon që, në rastin kur operatori ekonomik ofertues merr pjesë në më shumë se një Lot, atëherë ky i fundit duhet të paraqesë një deklaratë ku të listojë dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriteve kumulative për Lotin konkret.

III.2.5. Komisionit të Prokurimit Publik pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi i rezulton, se procedura në fjalë është procedurë e ndarë në lote. Gjithashtu nga verifikimi i loteve të publikuara si dhe databazës së regjistrit të ankesave rezulton, se operatori ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK rezulton pjesëmarrës (ofertues) në Lotin I, në Lotin II dhe në Lotin IV ku rezulton i kualifikuar në të tre Lotet.

Pra sa më sipër, operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, duke qenë së është pjesëmarrës në tre lote të kësaj procedure prokurimi, duhet të dorëzonte një deklaratë, ku të listonte dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka dorëzuar dokumentin “Autodeklaratë” datë 13.06.2023, ku ka listuar vetëm punonjësit që disponon për kryerjen e shërbimit, ndërkohë që referuar kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor, deklarata duhet të përfshije edhe kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), dokumentat për përmbushjen e të cilave nuk janë deklaruar nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, në respect të kriterit për kushtet kumulative.

III.2.6. KPP gjykon se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.2.7. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet se “*1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*” Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimin të kriterëve kualifikuese. Në

rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK me argumentin, se “Në dokumentat e tenderit është kërkuar:

[...]

Vlera e fondit limit të 3 loteve ku ka ofertuar ky OE është 34 100 071 lekë pa TVSH. Bazuar në kriterin e mësipërm të kualifikimit ky OE duhet të paraqiste dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në vlerën jo më pak se 13 299 027 lekë pa TVSH. Ky OE ka dështuar në plotësimin e këtij kriteri kualifikimi pasi nuk ka paraqitur dëshmi për shërbime të ngjashme në vlerën minimale prej 13 299 027 lekë pa TVSH. Sa më sipër oferta e këtij OE duhet të skualifikohet për mospërbushjen e këtij kriteri kualifikimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca “8, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, për Lotin 4, “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”, pika 2.1.1 dhe 2.1.2, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

1. **Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit të Lotit 4. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:**

a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të realizuara.

b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim, sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.

III.3.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Faturë tatimore shitje me nr.fature 267819730, datë 21.09.2020; nr.fature 267819690, datë 01.09.2020; nr.fature 267819718, datë 16.09.2020; nr.fature 267819813, datë 23.10.2020; nr.fature 267819808, datë 19.10.2020; nr.fature 267819860, datë 17.11.2020; nr.fature 267819853, datë 13.11.2020; nr.fature 267819901, datë 14.12.2020; nr.fature 267819885, datë 02.12.2020; nr.fature 267819900, datë 14.12.2020; nr.fature 267819834, datë 30.10.2020; nr.fature 267819799, datë 16.10.2020; nr.fature 267819835, datë 30.10.2020; nr.fature 267819764, datë 02.10.2020; nr.fature 267819760, datë 01.10.2020; nr.fature 267819817, datë 27.10.2020; nr.fature 267819504, datë 06.10.2020; nr.fature 267819739, datë 25.09.2020; nr.fature 267819708, datë 10.09.2020; nr.fature 267819738, datë 25.09.2020; nr.fature 267819695, datë 03.09.2020; nr.fature 267819711, datë 10.09.2020; nr.fature 267819708, datë 21.09.2020; nr.fature 267819727, datë 18.09.2020; nr.fature 267819732, datë 22.09.2020; nr.fature 267819753, datë 23.09.2020; nr.fature 267819751, datë 30.09.2020; nr.fature 267819707, datë 10.09.2020; nr.fature 267819732, datë 22.09.2020; nr.fature 267819665, datë 20.08.2020; nr.fature 267819666, datë 20.08.2020; nr.fature 267819669, datë 20.08.2020; nr.fature 267819668, datë 20.08.2020; nr.fature 267836408, datë 11.08.2020; nr.fature 267819601, datë 23.07.2020; nr.fature 2678195..30, datë 17.07.2020; nr.fature 105391, datë 01.12.2021; nr.fature 105923, datë 15.12.2021; nr.fature 105640, datë 08.12.2021; nr.fature 370119877, datë 26.01.2021; nr.fature 370120279, datë 06.02.2021; nr.fature 370120720, datë 19.02.2021; nr.fature 370120721, datë 20.02.2021; nr.fature 370120722, datë 20.02.2021; nr.fature 370121724, datë 19.03.2021; nr.fature 370131475/2021, datë 01.09.2021; nr.fature 370135353/2021, datë 07.12.2021; nr.fature 267836562, datë 17.08.2020; nr.fature 267835936, datë 16.07.2020; nr.fature 267835989, datë 21.07.2020; nr.fature 267835899, datë 15.07.2020; nr.fature 267819545, datë 08.07.2020; nr.fature 267819555, datë 10.07.2020; nr.fature 267819554, datë 08.07.2020; nr.fature 267819539, datë 03.07.2020; nr.fature 267835707, datë 03.07.2020; nr.fature 267835702, datë 02.07.2020; nr.fature 267835783, datë 08.07.2020; nr.fature 267835785, datë 08.07.2020; nr.fature 267835778, datë 08.07.2020;

nr.fature 267835543, datë 25.06.2020; nr.fature 267835354, datë 18.06.2020; nr.fature 267835414, datë 20.06.2020; nr.fature 267835440, datë 23.06.2020; nr.fature 267835545, datë 25.06.2020; nr.fature 267835638, datë 30.06.2020; nr.fature 267834996, datë 01.06.2020; nr.fature 267834997, datë 01.06.2020; nr.fature 267835036, datë 01.06.2020; nr.fature 267835244, datë 13.06.2020; nr.fature 267835254, datë 15.06.2020; nr.fature 267835255, datë 15.06.2020; nr.fature 107043, datë 26.07.2022; nr.fature 267836864, datë 27.08.2020; nr.fature 267836310, datë 06.08.2020; nr.fature 267836338, datë 08.08.2020; nr.fature 267836568, datë 18.08.2020; nr.fature 267819625, datë 10.08.2020; nr.fature 267836568, datë 18.08.2020

.....

Faturë tatimore shitje me nr.fature 4036/2023, datë 29.04.2023; nr.fature 107164, datë 28.07.2022; nr.fature 103437, datë 07.10.2021; nr.fature 103194, datë 02.10.2021; nr.fature 104498, datë 04.11.2021; nr.fature 104550, datë 05.11.2021; nr.fature 104551, datë 05.11.2021; nr.fature 104844, datë 12.11.2021; nr.fature 105576, datë 06.12.2021; nr.fature 105879, datë 14.12.2021; nr.fature 370130041, datë 08.02.2021; nr.fature 370130042, datë 08.02.2021; nr.fature 370130059, datë 18.02.2021; nr.fature 370120186, datë 04.02.2021; nr.fature 370130045, datë 10.02.2021; nr.fature 370121741, datë 20.03.2021; nr.fature 370121725, datë 19.03.2021; nr.fature 370121735, datë 20.03.2021; nr.fature 370123759, datë 09.06.2021; nr.fature 267836338, datë 08.08.2020; nr.fature 267819602, datë 23.07.2020; nr.fature 267819531, datë 06.07.2020; nr.fature 267819577, datë 15.07.2020; nr.fature 267819576, datë 15.07.2020; nr.fature 267819575, datë 15.07.2020; nr.fature 267819574, datë 15.07.2020; nr.fature 267819590, datë 17.07.2020; nr.fature 267819589, datë 17.07.2020; nr.fature 267819603, datë 24.07.2020; nr.fature 267819556, datë 10.07.2020; nr.fature 267819495, datë 17.06.2020; nr.fature 267819498, datë 22.06.2020; nr.fature 267819497, datë 19.06.2020; nr.fature 267819500, datë 23.06.2020; nr.fature 267819499, datë 22.06.2020; nr.fature 267819508, datë 25.06.2020; nr.fature 267819512, datë 29.06.2020; nr.fature 267835055, datë 03.06.2020; nr.fature 267835056, datë 03.06.2020; nr.fature 267835057, datë 03.06.2020; nr.fature 267819544, datë 08.07.2020; nr.fature 267819641, datë 13.08.2020; nr.fature 267819694, datë 08.09.2020; nr.fature 267819709, datë 10.09.2020; nr.fature 267819710, datë 10.09.2020; nr.fature 267819714, datë 14.09.2020;

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

III.3.5. Neni 39 “Ndarja e kontratave në lote”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.

Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet.

Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatohen për të përcaktuar lotet që do të jepen.

3. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

III.3.6. Neni 41 pika 3 “Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

III.3.7. Në nenin 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

6. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatohen për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kriterë duhet të jenë në përputhje me LPP-në dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.

7. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkojnë operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

III.3.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.9. Komisionit të Prokurimit Publik pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi i rezulton, se procedura në fjalë është procedurë e ndarë në lote. Gjithashtu nga verifikimi i loteve të publikuara si dhe databazës së regjistrit të ankesave rezulton, se operatori ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK rezulton pjesëmarrës (ofertues) në Lotin I, në Lotin II dhe në Lotin IV ku rezulton i kualifikuar në të tre Lotet.

Sa më sipër, referuar procedurës objekt shqyrtimi, konstatohet se operatori ekonomik ankimues “NRG” SHPK ngre pretendime për skualifikimin e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK, për mospërbushje të kriterit në lidhje me eksperiencën e ngjashme.

III.3.10. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit të Lotit 4. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë: a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.”*

Gjithashtu, në kriteret e veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor ka përcaktuar shënimin *“Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme”*.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton, se ky i fundit në të tre Lotet e ofertuar për këtë procedurë (Loti I, Loti II dhe Loti IV) ka dorëzuar të njëjtin dokumentacionin (fatura tatimore shitje) në lidhje me eksperiencën e ngjashme, si për Lotin 1 edhe për Lotin 2, edhe për Lotin 4 objekt shqyrtimi, ndërkohë që autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit ka përcaktuar se *“Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet*

të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.”

III.3.11. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, konstatohet se ky i fundit për të përmbushur kriterin e mësipërm ka paraqitur Fatura Tatimore ku vërtetohet se ka kryer shërbime të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit me disa institucione shtetërore dhe subjekte private. Nisur nga kriteri i kualifikimit, vlera e zërave të ngjashëm duhet përlllogaritur duke mbajtur në konsideratë vlerën e të tre loteve ku operatori ekonomik « Florfarma » SHPK është pjesëmarrës dhe i kualifikuar. Pra sa më sipër, duke qenë se operatori ekonomik « Florfarma » SHPK nga verifikimi në SPE konstatohet që ka paraqitur të njëjtin dokumentacion në lidhje me eksperiencën e e ngjashme, për të tre Lotet ku ka marrë pjesë, KPP nga përlllogaritja zërave të ngjashëm në faturat e paraqitura nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, konstaton se këto të fundit përmbushin vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor, ku në këtë rast referuar shënimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor *“Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku”,* duhet përlllogaritur në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së tre loteve ku operatori ekonomik ka marrë pjesë.

Sa më sipër, operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, përmbush kriterin në lidhje me eksperiencën e ngjashme në vlerën e kërkuar në kriteret e kualifikimit.

III.3.12. Komisioni rithekson se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit sa i takon eksperiencës së ngjashme, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK me argumentin, se “Numri I punonjësve për lotin objektin e ankimimi është 2 (dy).

Por ky OE ashtu sikurse theksuam edhe më sipër ka marrë pjesë në:

Lotin 1 – [...]

Lotin 2 – [...]

Pra kriteri kumulativ është që ku OE duhet të ketë minimum 4 (katër) punonjës shërbimi. Duke qenë se kriter kualifikimi është kërkuar staf për kryerjen e shërbimit, operatorët ekonomikë kishin detyrimin të paraqesnin kontratat e punës në mënyrë kumulative për aq punonjës sa kërkoheshin për lotet ku kishin ofertuar por edhe document provues (listëpagesat e muajit të fundit me kodin përkatës për punonjës shërbimi DDD ose dëshmi përkatëse për teknik DDD).

Nuk mund të quhet e vlefshme vetëm kontrata e punës me një punonjës kur nuk provohet se ai është punonjës shërbimi DDD.

Në objektin e veprimtarisë së tij OE “Florfarma”shpk ka disa aktivitete të tjera përveç shërbimit DDD por kjo nuk do të thotë që të kualifikohet duke paraqitur kontrata fictive punonjësish që nuk kanë të bëjnë me shërbimin – objekt prokurimi.

Ajo që provon se këta punonjës janë vërtet punonjës shërbimi DDD e vërteton ose dëshmia/certifikata e specializimit si teknik DDD ose listëpagesa e muajit të fundit me kodin korrespondues të punonjësit të shërbimit teknik DDD., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca “8, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, për Lotin 4, “Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

[...]

Shënim: *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme.*

III.4.2. Në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit, “Shtojcë Nr.1, datë 01.06.2023”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

LOTI 1

➤ SHTOHET:

1. *Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë te punesuar staf si me poshte:*

a) **1 (një) Drejtues Teknik**, Për drejtuesin teknik te paraqitet:

- *Kontrate pune perkatese.*

- *Diplomë me profil Agronom/Shëndet Publik/Biologji/Kimi.*
- b) **Minimalisht 1 (një) punonjës.** *Për punonjësin të paraqitet:*
 - *Kontrate pune perkatëse.*

LOTI 2

➤ **SHTOHET:**

1. *Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë te punesuar staf si me poshte:*
 - a) **1 (një) Drejtues Teknik.** *Për drejtuesin teknik te paraqitet:*
 - *Kontrate pune me profil Agronom/Shëndet Publik/Biologji/Kimi.*
 - b) **Minimalisht 1 (një) punonjës.** *Për punonjësin të paraqitet:*
 - *Kontrate pune perkatëse.*

LOTI 4

➤ **SHTOHET:**

1. *Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë te punesuar staf si me poshte:*
 - a) **1 (një) Drejtues Teknik.** *Për drejtuesin teknik te paraqitet:*
 - *Kontrate pune me profil Agronom/Shëndet Publik/Biologji/Kimi.*
 - b) **Minimalisht 2 (dy) punonjës.** *Për punonjësin të paraqitet:*
 - *Kontrate pune perkatëse.*

III.4.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Autodeklaratë datë 13.06.2023, në lidhje me Punonjësit që disponon për kryerjen e shërbimit.

III.4.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto

dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.5. Sa më sipër, referuar kriterit të mësipërm të kualifikimit, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që *“Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1), të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të kualifikohet vetëm në atë Lot ku oferta e tij është ekonomikisht më e favorshme”*. Pra, sa më sipër, autoriteti kontraktor kërkon që, në rastin kur operatori ekonomik ofertues merr pjesë në më shumë se një Lot, atëherë ky i fundit duhet të paraqesë një deklaratë ku të listojë dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret.

III.4.6. Komisionit të Prokurimit Publik pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi i rezulton, se procedura në fjalë është procedurë e ndarë në lote. Gjithashtu nga verifikimi i loteve të publikuara si dhe databazës së regjistrit të ankesave rezulton, se operatori ekonomik ankimues “Florfarma” SHPK rezulton pjesëmarrës (ofertues) në Lotin I, në Lotin II dhe në Lotin IV ku rezulton i kualifikuar në të tre Lotet. Pra sa më sipër, operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, duke qenë së është pjesëmarrës në tre lote të kësaj procedure prokurimi, duhet të deklarojë se disponon 3 drejtues teknik dhe 4 punonjës, në përmbushje të kriterit kumulativ. Në rastin konkret, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Florfarma” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka dorëzuar dokumentin “Autodeklaratë” datë 13.06.2023, ku ka listuar punonjësit që disponon për kryerjen e shërbimit, duke deklaruar 3 drejtues teknik dhe katër punonjës, duke përmbushur kështu numrin e punonjësve për të tre lotet ku është pjesëmarrës. Vlen të theksojmë se, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues në lidhje me 4 punonjësit, nga verifikimi i dokumentave të tenderit, konstatohet se autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar ndonjë kualifikim specifik për këta punonjës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK për parregullsi të procedurës së prokurimit “Konsideruar sa më sipër, arrijmë në konkluzionin që profesionaliteti dhe njohurite ë fushës dhe ato juridike të anëtarëve të KVO lënë shumë për të dëshiruar, apo në të kundërt kanë mbyllur sytë qëllimish. Specialistët e ISHP që hartuan specifikimet teknike sipas VKM nr 933 datë 25.11.2020 E.R dhe Z.S qëllimisht nuk e kishin përcaktuar shtamin e produktit bti në dokumentat e tenderit madje nuk kishin vendosur asnjë kriter kualifikimi teknik për produktin. themi qëllimisht pasi vetëm në këtë mënyrë do të favorizonin duke marrë guximin të kualifikonin OE Egian Med shpk dhe pse produkti I tij është I pavlefshëm pasi nuk është në listen e përbërësve aktivë të miratuar në Republikën e Shqipërisë. Jo më kot është E.R që përgatit specifikimet teknike të tenderit dhe merr pjesë gjithashtu në grupin që lëshon Autorizim importi. Të dy këta punonjës të ISHP në bashkëpunim me njëri tjetrin kanë shpërdoruar detyrën duke ndihmuar OE Egian Med të regjistrojë produktet Aquabac dhe për këto veprime shoqëria jonë do të kërkojë përgjegjësitë penale pranë institucioneve kompetente [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Me anë të shkresës nr. 714/1 prot., datë 25.07.2023, protokolluar pranë KPP-së me nr.1610/7 prot., datë 28.07.2023, Instituti i Shëndetit Publik na vendos në dijeni se: “[...] Sqarojmë se z.R nuk është pjesë përbërëse e Komisionit për Autorizimin e Produkteve Biocide. Bazuar ne VKM nr.933, datë 25.11.2020, Instituti I Shëndetit Publik nuk ka të drejtë vendimmarrje për dhënie e Autorizimeve të Produkteve Biocide, por I jep mendim MSHMS në bazë të një vlerësimi që kryhet nga specialistet përkatës për çdo produukt biocid. Ky mendim më pas shqyrtohet nga Komisioni për Autorizimin e Produkteve Biocide në MSHMS. Z. E.R nuk kryen vlerësimin e PB insecticide (PT 18) në kuadër të procedurës së autorizimit të produkteve biocide. Në lidhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, nuk ka patur kërkesa për sqarime apo ankime lidhur me këto specifikime pas publikimit të procedurës. Në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, të kryer nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, Z. Rnuk është pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertavr për këtë procedurë.”

III.5.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

Neni 18 “Mbrotjtja e integritetit të procedurës dhe masat e përgjithshme për parandalimin e korrupsionit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Prokurimi publik duhet të zhvillohet në mënyrë transparente me paanshmëri dhe pa asnjë trajtim preferencial. Procedurat e prokurimit duhet të kërkojnë standardet më të larta të etikës dhe besimit publik. Në çdo rast duhet të shmanget rreptësisht çdo konflikt interesi ose edhe shfaqja e një konflikti interesi, në marrëdhëniet e titullarit të autoritetit kontraktor, punonjësit të angazhuar në procesin e prokurimit dhe operatorit ekonomik, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike. 2. Punonjësit e autoritetit ose entit kontraktor, të angazhuar në përgatitjen e dokumenteve të tenderit nuk mund të jenë ofertues ose anëtarë në një grup ofertuesish në procedurën e prokurimit. 3. Autoriteti ose enti kontraktor është i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme në procesin e planifikimit, në procedurën e prokurimit publik dhe në zbatimin e kontratës, me qëllim zbulimin në kohë të korrupsionit dhe eliminimin e pasojave të dëmshme të korrupsionit. 4. Çdo zyrtar i angazhuar në procesin e prokurimit nga autoriteti ose enti kontraktor dhe çdo palë e interesuar që ka informacione për korrupsionin është i detyruar të informojë organet kompetente. 5. Operatorët ekonomikë me veprimet e tyre nuk duhet të shkelin parimet e konkurrencës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi”.

Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

III.5.3. Në nenin 108 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Neni 108 Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik;

ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose

iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;

b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale;

c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal;
ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shpre-himisht në ligj”.

III.5.4. Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjithashtu, referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, ligji parashikon për herë të parë në një nen të posaçëm, mbrojtjen e integritetit të procedurës. Gjithashtu, autoriteti ose enti kontraktor është i detyruar marrë të gjitha masat e nevojshme në procesin e planifikimit në procedurën e prokurimit publik dhe në zbatimin e kontratës, me qëllim zbulimin në kohë të korrupsionit apo konfliktit të interesit dhe eliminimin e pasojave të dëmshme të arrdhura si rrjedhojë apo pasojë të këtyre konstatimeve. Me qëllim, shmangien e konfliktit të interesit në procesin e prokurimit, ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikon detyrimin e autoriteteve për marrjen e masave të përshtatshme për të parandaluar, identifikuar dhe korrigjuar rastet e konfliktit, si dhe për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës, e për të garantuar trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

KPP referuar pretendimeve të ankimuesit, për sa kohë ky i fundit gjykon se procedura e prokurimit është zhvilluar në shkelje të ligjit, KPP në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 20.10.2021 “Për krijimin, organizimin, e funksionimin e rrjetit të koordinatorëve kundër korrupsionit” gjykon, se ky rast duhet t’iu referohet të tjera institucioneve të posaçme, konkretisht Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit.

III.6. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues BOE “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK, se arsyeja e skualifikimit “Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat sipas Pikës 1 Seksioni 2.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” të Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit sipas shtojcës 1 dt.01.06.2023, pasi operatori “VLERA” sh.p.k pajisut me NIPT nga organet tatimore në Kosovë me nr. 81OI98772 nuk ka paraqitur Liçencën për kategorinë II.8.B. Në zbatim të nenit 88, të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, kushti për licensën është i detyrueshëm për secilin nga antarët e bashkimit të operatorëve pasi kapacitetet teknike duhet të vërtetohen nga sicili antar në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim. Gjithashtu operatori i huaj në këtë rast VLERA sh.p.k nuk mund të kryejë shërbime të dezinsketimit në territorin e Republikës së Shqipërisë me licensën e lëshuar në Kosovë por detyrimisht duhet të ishte paisur me Liçencën për kategorinë II.8.B, sipas shtojcës 1 të DST dhe Legjislacionit në fuqi, përpara paraqitjes të ofertës në formën e bashkimit të OE, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën për modifikimin e dokumentave të tenderit, “Shtojcë Nr.1, datë 01.06.2023”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

LOTI 4

➤ **Në Shtojcën 8 “Formular I Kriteve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit” seksioni 2.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” në Dokumenteve të Tenderit:**

SHTOHET

2. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes Liçencë per kategorine II.8.B “Shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te jete i licensuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nen ligjore.*

Shënim:

Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues duhet të paraqesë Licencën e kerkuar prane AK.

III.6.2. Me vendimin nr. 399/2023, datë 18.05.2023, Komisioni i Prokurimit Publik, lidhur me shtimin e kriterit kualifikues të sipërpërmendur është shprehur si më poshtë:

[...] Në interpretim të dispozitave ligjore të fushës së prokurimit, vlen të theksojmë se së pari, ligjvënësi ka parashikuar dy natyra kriteresh kualifikimi, kriteret të cilat përcaktohen me ligj, si dhe kriteret dhe kërkesat të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në përputhje me llojin, volumin, sasinë, specifikat e shërbimit që kërkohet të prokurimet, me qëllim realizimin me sukses dhe cilësi të tij. Kriteret e përcaktuara me ligj mund të parashikohen nga ligji për prokurimin publik dhe rregullat në përputhje me të, gjithashtu mund të përcaktohen kriteret të cilat bazohen në ligje specifike, në varësi të fushës apo objektit që kërkohet të realizohet.

Gjithashtu, Komisioni konstaton se në rastin konkret, qëllimi përfundimtar i autoritetit kontraktor është kryerja e shërbimit të dezinfektimit në zonat bregdetare dhe urbane.

Në nenin 5 të Ligjit nr.10/081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.”

Ndërkohë, në nenin 6 të ligjit parashikohet se “Ushtrimi i një veprimtarie apo kryerja e një veprimi nëpërmjet licencimit apo, përkatësisht, autorizimit bëhet vetëm nëse plotësohen këto dy rrethana:

a) ushtrimi i veprimtarisë apo kryerja e veprimit në mënyrë të parregullt mund të cenojë jetën, shëndetin, të drejtat e interesat e ligjshëm të shtetasve, sigurinë e rendin publik, sigurinë kombëtare, konkurrencën e ndershme apo mirëfunksionimin e tregut, një të mirë publike, objektivat socialë dhe çdo interes tjetër publik të kësaj natyre;

b) garantimi i përshtatshëm i interesave të përcaktuar në shkronjën “a” të këtij neni, pavarësisht ekzistencës së rregullave, të standardeve e mekanizmave vlerësues, vëzhgues dhe ndëshkues të mëpasshëm, nuk mund të arrihet pa një proces vetëdeklarimi, shqyrtimi, inspektimi e vlerësimi të përmbushjes së disa kriteve të paracaktuara, përpara fillimit të veprimtarisë apo të kryerjes së veprimit.”

Ndërsa referuar VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës Kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera Nënligjore të përbashkëta”, në Aneksin I të vendimit të mësipërm, ligjvënësi ka parashikuar: “Kategoritë e licencave e lejeve që si rregull trajtohen nga ose nëpërmjet qkl-së”, ku konstatohet se; “Veprimtaritë që kryejnë “shërbime të tjera shëndetësore ose higjiëno-sanitare” janë ato të përcaktuara në kategorinë II.8 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Veprimtaritë e kësaj kategorie ndahen në dy nënkategori si vijon:

a) “shërbime ekspertize higjiëno-shëndetësore” me kodin II.8.A; dhe

b) “shërbime ndërhyrëse higjiëno-shëndetësore” të tilla dezinfektimi, deratizimi, dizensektimi dhe të tjera të këtij lloji me kodin II.8.B.”

Pra, shoqëritë të cilat kryejnë veprimtari shërbime ndërhyrëse higjiëno-shëndetësore të tilla si dezinfektimi, deratizimi, dizensektimi dhe të tjera, duhet të pajisjen më licencë përkatëse duke plotësuar disa kushte specifike.

Referuar procedurës konkrete objekt-shqyrtimi, konstatojmë se blerja e mallit nga subjektet të

cilat ofrojnë shërbimin objekt-prokurimi, ka një rregullim të posaçëm ligjor dhe kryhet sipas disa procedurave specifike, duke u shoqëruar me dokumentacion përkatës, për vendosjen e tyre në treg (Ligji 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe rregullat në zbatim të tij).

...

Gjithashtu, vlen të theksojmë se, për analogji, krahasuar me procedurën me objekt të njëjtë të zhvilluar për vitin kaluar 2022, për të cilën u paraqitën ankesa pranë Komisionit të Prokurimit

Publik për modifikimin e dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor, në procedurën e këtij viti ka modifikuar tërësisht kriteret e kualifikimit për këtë procedurë krahasuar me vitin e mëparshëm. Sa më sipër, KPP konstaton se në rishpalljen e kësaj procedurë kualifikimi, autoriteti kontraktor nuk ka vendosur kritere kualifikimi.

Sa më sipër, gjykojmë se autoriteti kontraktor, nisur nga lloji i kësaj procedure prokurimi, kompleksiteti i saj, rëndësia dhe impakti që ka në jetën e njeriut, brenda diskrecionit të lejuar nga ligji, duhet të rishikojë kriteret e vecanta të kualifikimit në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik si dhe legjislacionit të fushës përkatëse, më qëllim që të sigurohet që ky shërbim do të realizohet nga subjekte të cilat kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për realizimin me përgjegjshmëri dhe saktësi të këtij shërbimi.

Akoma më tej, mënyra e hartimit të kriterëve ndikon drejtpërdrejt në fazën e vlerësimit të kësaj procedure prokurimi, duke kualifikuar ato operatorë të cilat kanë kapacitete e duhura ligjore për ushtrimin dhe realizimin e objektit të prokurimit.[...].

III.6.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Egian Med” SHPK & “Vlera” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë bashkëpunimi datë 12.06.2023 midis shoqërisë “Egian Med” SHPK dhe “Vlera” SHPK, për Lotin 4, ku shoqëria “Vlera” SHPK merr përsipër 39 % të të gjithë objektit të kontratës dhe “Egian Med” SHPK merr përsipër 63 % të të gjithë objektit të kontratës;
- Dokumenti datë 16.12.2022, Ref.04.5-516/22 “Për dhënie e lejes së përkohshme” ku citohet “1. I lejohet përkohësisht operatorit parashtruara Vlera shpk me seli në shtime për kryerja e punëve profesionale të Dezinsektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit. 2. Kryerja e punëve profesionale të përcaktuara nga pika 1 e këtij vendimi, lejohet në afat të caktuar nga dt. 16.12.2022 deri më 16.06.2023.”, lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Kosovë, shoqëruar me Vërtetim i kopjes nga origjinali, LRP.nr.698/2023.

III.6.4. Në ligjin Nr.95/2015, datë 08.05.2003 “Për Shërbimet dhe Produktet Biocide në Shëndetin Publik”, neni 6, është përcaktuar:

1. Prodhimi i produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, të licencuar, që plotësojnë kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
2. Kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë personat fizikë ose juridikë, për t’u licencuar për prodhimin e produkteve biocide, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ndërsa në neni 9 parashikohet:

2. Vendosja në treg e produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, të cilët, pavarësisht nga sasia e produktit, plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë të kontraktuar njëperson, në pozicionin e drejtuesit teknik, të diplomuar në degët biologji, kimi, agronomi ose shëndet publik;
 - b) kanë mjedise të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit, garantojnë kushte për sigurinë e personelit;
 - c) kanë klasifikuar, paketuar dhe etiketuar produkte biocide, sipas dokumentacionit të autorizimit të produktit;
 - ç) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë mjedise të veçanta tregtimi.

III.6.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.6.6. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.6.7. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.6.8. Autoriteti kontraktor me anë të kriterit kualifikues të sipërpërmendur ka përcaktuar që operatorët ekonomik ofertues duhet të dëshmojnë se zotërojnë aftësinë teknike për realizimin e objektit të prokurimit, ku kjo aftësi teknike konsiston në zotërimin e licensës përkatëse të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit në lidhje me prodhimin dhe tregtimin e produkteve biocide, sikurse parashikon dhe në legjislacionin sektorial që vendos rregulla strikte mbi mënyren e përdorimit të këtyre produkteve të cilat kanë një impakt të madh në shëndetin e njerzve dhe në mjedis.

Sa më sipër, nisur nga arsyeja e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimue, si dhe pretendimet e këtij të fundit, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues rezultoi se, njëri nga anëtarët e këtij bashkimi shoqërisht dhe konkretisht operatori ekonomik “Egjan Med” SHPK ka paraqitur licensën e kategorisë II.8.B të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, ndërsa anëtarit tjetër dhe konkretisht operatori ekonomik “Vlera” SHPK është shoqëri e huaj e cila e ushtron aktivitetin e saj në Republikën e Kosovës dhe ka paraqitur Dokumentin datë 16.12.2022, Ref.04.5-516/22 “Për dhënie e lejes së përkohshme” ku citohet “1. I lejohet përkohësisht operatorit parashtruar Vlera shpk me seli në shtime për kryerja e punëve profesionale të Dezinfektimit, Dezinfektimit dhe Deratizimit. 2. Kryerja e punëve profesionale të përcaktuara nga pika 1 e këtij vendimi, lejohet në afat të caktuar nga dt. 16.12.2022 deri më 16.06.2023.”, lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Kosovë, si dhe është shoqëruar me Vërtetim i kopjes nga origjinali, LRP.nr.698/2023. Referuar marrëveshjes midis shtetit Shqiptar dhe Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi në datë 30.06.2022, e marrëveshje

reciproke vendet si Kosova janë të përjashtuara nga detyrimi i legalizimit ose apostilimit paraprak të dokumenteve. Autoritetet shqiptare pranon dokumentet e këtyre vendeve pa formalitete të tjera.

Ndërkohë, lidhur me vlefshmërin e Dokumentit datë 16.12.2022, Ref.04.5-516/22 “Për dhënie e lejes së përkohshme” të dorëzuar nga shoqëria “Vlera” SHPK për plotësimin e kriterit kualifikues të sipërpërmendur, KPP gjykon se, referuar nenit 6 të ligjit Nr.95/2015, datë 08.05.2015 “Për Shërbimet dhe Produktet Biocide në Shëndetin Publik”, ku përcaktohet se: “1. Prodhimi i produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, të licencuar, që plotësojnë kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.”, si dhe pikës 2 të nenit 9 ku përcaktohet se: “Vendosja në treg e produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit”, dokumenti i mësipërm nuk plotëson kriterin kualifikues pasi referuar ligjit të posaçëm Nr.95/2015, datë 08.05.2003 “Për Shërbimet dhe Produktet Biocide në Shëndetin Publik”, përcaktohet qartësisht se të gjithë subjektet të cilët kërkojnë të vendosin në treg produkteve biocide duhet të jenë të licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, ndërkohë që shoqëria “Vlera” SHPK e cila ka marrë përsipër që të realizojë 39% të shërbimit objekt-prokurimi, nuk mund ta realizojë këtë shërbim pa u pajisur me licensën përkatëse të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit në Republikën e Shqipërisë. Pra, sa më sipër, gjykojmë se, dokumenti i dorëzuar nga operatori ekonomik “Vlera” SHPK si anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues, nuk është i vlefshëm, pasi ky i fundit duhet të licensohej pranë Shtetit Shqiptar referuar pikës 2 të nenit 9 të ligjit Nr.95/2015, datë 08.05.2003 “Për Shërbimet dhe Produktet Biocide në Shëndetin Publik”.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “Nga bashkimi i operatorëve “EGIAN MED” sh.p.k dhe “VLERA” sh.p.k në Kontratën e Bashkëpunimit midis operatorëve është deklaruar ndarja e punëve përkatësisht: “VLERA” sh.p.k merr përsipër 39% të punëve dhe “EGIAN MED” sh.p.k 63% të punëve. Ndërkohë në zërat e vlerave të deklarauara në tabelën e ndarjes së punëve, shifrat e deklarauara nga përfitimi i ndarjes së punëve sipas zërave janë të ndryshme nga ajo e deklaruar nga kontrata e bashkëpunimit, pasi rezulton se “VLERA” sh.p.k do të kryjë 27% të ofertës dhe “EGIAN MED” sh.p.k të 73% ofertë.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, të dokumentave të tenderit përcaktohet:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

III.7.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK dhe “Vlera” SHPK të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se është paraqitur si më poshtë vijon:

- Kontratë bashkëpunimi datë 12.06.2023 midis shoqërisë “Egian Med” SHPK dhe “Vlera” SHPK, për Lotin 4, ku shoqëria “Vlera” SHPK merr përsipër 39 % të të gjithë objektit të kontratës dhe “Egian Med” SHPK merr përsipër 63 % të të gjithë objektit të kontratës;
- Formulari i ofertës

Gjithashtu konstatohet se në sistemin e prokurimeve elektronike është paraqitur dokumenti me emërtimin Ofera ekonomike.

III.7.3. Në nenin 14, “Operatorët ekonomikë”, pika 2 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet: *“Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje. Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës. 3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”.*

Ndërsa në nenin 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1.Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të

madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

4. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.

5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

6. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorin/ët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti/enti kontraktor zgjidh kontratën.”

III.7.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *I.Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.7.5. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.7.6. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt ligjit dhe rregullave të prokurimit publik.

III.7.7. Operatori ekonomik në ankesën e tij ndër të tjera pretendon: “...është e vërtetë se ka një gabim (lapsus) në kthimin e vlerës së secilit operator në % respektive referuar vlerës së shërbimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik, pjesë e bashkimit, por ky gabim në llogaritje i vlerës në përqindje (%) së shënuar në kontratën e bashkëpunimit, nuk është arsye për skualifikimin e ofertës së paraqitur në këtë tender nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK dhe “Vlera” SHPK” [...].

III.7.8. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, si dhe pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, KPP nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK dhe “Vlera” SHPK, rezulton se në këtë dokument në nenin 4 të tij, janë përcaktuar përqindjet e marra përsipër nga secili operator në këtë bashkim. Konkretisht, operatori ekonomik “Vlera” SHPK do të realizojë 39 % të të gjithë objektit të kontratës, ndërsa operatori ekonomik “Egian Med” SHPK, ka marrë përsipër se do të realizojë 73 % të të gjithë objektit të kontratës, por konstatohet se, përqindja e marrë përsipër nga secili anëtarë i këtij bashkimi nuk është përcaktuar në përputhje me ndarjen reale të zërave që ka marrë përsipër secili prej tyre, duke krijuar kështu konfuzion dhe paqartësi për autoritetin kontraktor, për vlerësimin e ofertës së këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

Sqarojmë se bazuar nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar qartësisht se “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

Në kuptim të sa më sipër, në marrëveshjen e bashkëpunimit duhet të përcaktohet qartë përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit, si edhe elementët konkretë që do të kryejë secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Pra, marrëveshja e bashkëpunimit, që të konsiderohet e saktë e në përputhje me legjislacionin në fuqi, përbëhet nga disa të dhëna, një prej të cilave është edhe përcaktimi i përqindjes së bashkëpunimit si dhe elementëve konkretë të zërave të punëve që do të kryhet nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë, pra ndarja e përqindjes së bashkëpunimit duhet të jenë të përcaktuar në marrëveshjen e detajuar të bashkëpunimit. Ndërkohë që në rastin konkret, ndarja e përqindjes së bashkëpunimit është e ndryshme nga ndarja e zërave, në kontratën e bashkëpunimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në marrëveshjen e bashkëpunimit, ashtu siç edhe përcaktohet në legjislacionin në fuqi, përcaktohen të gjitha të dhënat sic janë përqindja e bashkëpunimit si edhe zërat/elementët konkretë që do të marrë përsipër për të kryer secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Sa më sipër, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK dhe “Vlera” SHPK, nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë në përputhje me dokumentat e tenderit dhe nenin 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Egjan Med” SHPK dhe “Vlera” SHPK në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet si i vlefshëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimet bashkimit të operatorëve ekonomikë “Egjan Med” SHPK dhe “Vlera” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar arsyetimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përbushur kështu interesin e ankimuesit. Rrjedhimisht pretendimet e ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.9. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Egjan Med” SHPK dhe “Vlera” SHPK mbi shtimin e arsyeve të shoqërisë “RSM Company” SHPK Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i kësaj shoqërie është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 23.06.2023, ku kjo shoqëri rezulton e skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që ky operator ekonomik të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur operatorit ekonomik “NRG” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-66559-04-19-2023, me objekt: Loti 4 “Shërbim Dezinsektimi

në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”, me fond limit 15.479.671 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “NRG” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-66559-04-19-2023, me objekt: Loti 4 “*Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës*”, me fond limit 15.479.671 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 13.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
3. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Egian Med” SHPK dhe “Vlera” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Florfarma” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operatorë ekonomik.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “NRG” SHPK.
7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifave financiare të paguara nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Egian Med” SHPK dhe “Vlera” SHPK.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit.
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri